

EPPC Albania kërkon një **Senior Sales Executive** për klientin e saj, përfaqësues ekskluziv i një prej prodhuesve ndërkombëtar më të mëdhenj në botë të sistemeve të trajtimit të ujit dhe produkteve të tij.

## Përgjegjësitë Kryesore:

1. Menaxhon të gjithë ciklin e shitjeve;
2. Ndërton dhe mban marrëdhënie me klientët biznese nëpërmjet vizita periodike duke identifikuar nevojat specifike të tyre, ofruar informacionin e duhur teknik rreth produkteve dhe duke ju rekomanduar zgjidhjet e nevojshme;
3. Analizon mundësitë e biznesit, identifikon klientë të rinj, vlerëson potencialin dhe nevojat e tyre bazuar në sektorët/industrinë ku operojnë si dhe hulumton dhe analizon opsionet e duhura të shitjes;
4. Mirëmban marrëdhëniet me klientët duke ju ofruar mbështetje, informacion, udhëzimet e nevojshme si edhe nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit;
5. Bashkëpunon me departamentet e tjera me qëllim koordinimin dhe ofrimin e një shërbimi të shkëlqyer dhe në kohë tek klientët biznese;
6. Përmirëson arritjet dhe kompetencat e stafit nëpërmjet transferimit të informacionit të nevojshëm teknik dhe procedural tek ta, mentorimit të tyre etj;
7. Përgatit raporte duke mbledhur, analizuar dhe përpunuar informacionin e duhur bazuar edhe në konkurrencën në treg;
8. Raporton në mënyrë periodike tek CEO i kompanisë.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- Eksperiencë e mëparshme në shitje B2B në pozicione Senior jo më pak se 3 vjet (*domosdoshmëri*);
- Te njoh mirë paketën MS Office (*kryesisht Word, Excel*);
- Të njoh shumë mirë gjuhën Angleze;
- Aftësi shumë të mira komunikimi, negocimi dhe analitike
- Të jetë i/e orientuar drejt marrëdhënieve me klientin;
- Të ketë leje drejtimi automjeti.

## Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Senior Sales Executive B2B;
<b>Udhëtime pune:</b>	Po, brenda vendit;
<b>Raporton:</b>	Administratori
<b>Pagesa:</b>	Ndër më të mirat në treg ( <i>fikse + bonuse + makinë, etj</i> );
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	28.12.2018.

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

[aplikim.eppc.al](http://aplikim.eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.  
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.